

Lista e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë e pagesës

Termi	Përkufizimi
Mirëmbajtja e llogarisë	Ofruesi i shërbimeve të pagesave administron llogarinë, duke bërë të mundur që konsumatori ta përdorë atë.
Kredi kufi	Ofruesi i llogarisë i jep konsumatorit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari, deri në një kufi të paracaktuar në kontratë.
Debitim direkt	Është një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së konsumatorit, ku një transaksion pagese inicohet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që konsumatori i ka dhënë përfituesit të pagesës, ofruesit të shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose ofruesit të shërbimit të pagesave të vetë konsumatorit.
Pagesa periodike	Ofruesi i llogarisë kryen transferime të rregullta, sipas udhëzimit të konsumatorit, të një shume fikse parash nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër.
Transferta në nisje brenda Shqipërisë nëpërmjet platformës <i>online</i>	Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër brenda Shqipërisë, nëpërmjet platformës <i>online</i> .
Transferta në nisje jashtë Shqipërisë nëpërmjet platformës <i>online</i>	Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër jashtë Shqipërisë, nëpërmjet platformës <i>online</i> .
Transferta në nisje brenda Shqipërisë në degë	Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër brenda Shqipërisë, nëpërmjet rrjetit të degëve të ofruesit të llogarisë.
Transferta në nisje jashtë Shqipërisë në degë	Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër jashtë Shqipërisë, nëpërmjet rrjetit të degëve të ofruesit të llogarisë.
Transferta në mbërritje brenda Shqipërisë	Kur fondet dërgohen në llogarinë e konsumatorit nga një llogari brenda Shqipërisë.

Transferta në mbërritje jashtë Shqipërisë	Kur fondet dërgohen në llogarinë e konsumatorit nga një llogari jashtë Shqipërisë.
Tërheqja e fondeve në para fizike brenda Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit	Konsumatori tërheq fonde në para fizike nëpërmjet kartës së debitit nga llogaria e tij në një ATM brenda Shqipërisë.
Tërheqja e fondeve në para fizike jashtë Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit	Konsumatori tërheq fonde në para fizike nëpërmjet kartës së debitit nga llogaria e tij në një ATM jashtë Shqipërisë.
Pagesa me kartë debiti brenda Shqipërisë	Konsumatori përdor kartën e tij të debitit për të kryer një pagesë brenda Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan ose në internet.
Pagesa me kartë debiti jashtë Shqipërisë	Konsumatori përdor kartën e tij të debitit për të kryer një pagesë jashtë Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan.
Pagesa me kartë krediti brenda Shqipërisë	Konsumatori përdor kartën e tij të kreditit për të kryer një pagesë brenda Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan ose në internet.
Pagesa me kartë krediti jashtë Shqipërisë	Konsumatori përdor kartën e tij të kreditit për të kryer një pagesë jashtë Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan.